

11.5.2016

Komisioni
të reformës
përmirësuese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



shërbimet

bo seancës

Nr ____ prot

Tiranë, më ____ 2016

Lënda : Propozim nisme ligjore të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Drejtuar : Z. Ilir META
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Tiranë

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, një grup deputetësh, depoziton për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën ligjore “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Bashkëlidhur janë teksti i nismës ligjore dhe relacioni shoqërues i tij.

DEPUTETËT NISMËTARË:

Olta Xhaka

Vanilma Hysi

Erjona Allaj

Klodian Spahiu

Mirëla Ferrica

Valentina Leskaj

Olta Xhaka

Vanilma Hysi

Erjona Allaj

Klodian Spahiu

Komiteti i Nismës

6. Nino Schuler *not*
7. Antonio Shump *off*
8. Eric Tush *on*
9. Blume Gyrameti *off*
10. Adeline Rosta *off*
11. Eskejil Pabel *off*
12. Anita Agallu *off*
13. Esmeralda S. *off*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Projekt

L I G J

Nr..... datë 2016

**“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 “KODI
ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar bëhen këto ndryshime :

Neni 1

Në nenin 67 të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1) a) Neni 67, pika 1, në fund të fjalisë së parë, të shtohet fjalia si vijon:

“50 përqind e listës shumëmemërore duhet t'i përkasë secilës gjini”.

b) Në fund të pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“Partia politike depoziton paraprakisht në KQZ jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve për Kuvendin listën shumëmemërore të kandidatëve për deputetë.

KQZ bën verifikimin e listës për kriterin e gjinisë dhe nëse vëren mosplotësim të këtij kriteri, brenda tre ditëve nga depozitimi i tyre, i kthen për plotësim. Lista e korrigjuar ridepozitohet jo më vonë se 55 ditë para datës së zgjedhjeve. KQZ merr vendim për pranimin ose refuzimin e listës së kandidatëve jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. KQZ njofton menjëherë KZAZ-të për listat e kandidatëve të partive politike të miratuara nga KQZ”.

2) a) Neni 67, pika 2, në fund të fjalisë së parë të shtohet fjalia si vijon:

“50 përqind e listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini”.

b) Në fund të pikës 2, të shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“Koalicionet depozitojnë paraprakisht në KQZ jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve listën shumemërore të kandidatëve për deputetë.

KQZ bën verifikimin e listës për kriterin e gjinisë dhe nëse vëren mosplotësim të këtij kriteri, brenda tre ditëve nga depozitimi i tyre, i kthen për plotësim. Lista e korrigjuar ridepozitohet jo më vonë se 55 ditë para datës së zgjedhjeve. KQZ merr vendim për pranimin ose refuzimin e listës së kandidatëve jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. KQZ njofton menjëherë KZAZ-të për listat e kandidatëve të koalicioneve të miratuara nga KQZ”.

3) Neni 67, pika 6, fjalia e parë të ndryshohet si vijon:

“6. Në zgjedhjet për Kuvendin, për çdo zonë zgjedhore, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje të të gjithë listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini”.

Neni 2

Në nenin 68, në fund të pikës 1 të shtohet fjalia:

“50 përqind e listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ilir META